

**UNIVERSITETI POLITEKNIK, TIRANË**  
**FAKULTETI I GJEOLGJISE DHE I MINIERAVE**

---

*Adresa: Rruga e Elbasanit, Tiranë - Albania*


*Tel/Fax: 35542375 246/5*

*E-mail: [fgjeolmin@yahoo.com](mailto:fgjeolmin@yahoo.com)*

*<http://www.dibmin-fgjm.org/doktorata/>*

**RREGULLORJA E PROGRAMIT TË  
STUDIMEVE TË DOKTORATËS NË  
“GJEOSHKENCAT, BURIMET NATYRORE  
DHE MJEDISI”**

**TIRANË, MARS 2013**



**UNIVERSITETI POLITEKNIK, TIRANË**  
**FAKULTETI I GJEOLGJISE DHE I MINIERAVE**

*Adresa: Rruga e Elbasanit, Tiranë - Albania*

*Tel/Fax: 35542375 246/5*

*E-mail: [fgjeolmin@yahoo.com](mailto:fgjeolmin@yahoo.com)*

*<http://www.dibmin-fgjm.org/doktorata/>*

## Hyrje

Programet e studimeve të doktoratës janë programe të studimeve të ciklit të tretë, me karakter plotësisht akademik, që kanë në bazë kërkim shkencor dhe veprimtari krijuese; Në studimet e doktoratës pranohen kandidatë që kanë fituar diplomë universitare "Master i shkencave".

Këto programe të studimeve zgjasin të paktën 3 vite akademike dhe përfshijnë 60 kredite për studime të organizuara teorike.

Në përfundim të programeve të studimeve të doktoratës lëshohet diploma për gradën shkencore "Doktor" (Dr).

Hapja e Programit të Studimeve të Doktoratës në **Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave** të Universitetit Politeknik të Tiranës në "**Gjeoshkencat, Burimet Natyrore dhe Mjedisi**", si program studimi i ciklit të tretë është bërë me Vendim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë Nr. 855, datë 5.08.2009. Në përfundim të këtij programi lëshohet diploma për gradën shkencore "Doktor (Dr.) në Gjeoshkencat, Burimet Natyrore dhe Mjedisi".

Kjo Rregullore është hartuar bazuar në:

- **Ligjin Nr. 9741**, datë 21/05/2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar me Ligjet Nr. 9832 datë 12/11/2007 dhe Nr 10307 , datë 22/07/2010.
- **VKM Nr. 864**, datë 05/12/2007 "Për hapjen e programeve të studimeve të Doktoratës në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë dhe përcaktimin e kushteve që duhet të plotësojë studenti për marrjen e diplomës për gradën shkencore "Doktor"
- **Udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr 5**, datë 22/01/2008 "Për përcaktimin e standarteve akademike të nevojshme për hapjen, mbylljen dhe riorganizimin e programeve të studimit të Doktoratës, si dhe të elementëve bazë sipas të cilave IAL duhet të përgatisin rregulloren përkatëse"
- **VKM Nr 877**, datë 18/06/2008 "Disa ndryshime në VKM 864, të datës 05/12/2007 "Për hapjen e programeve të studimeve të Doktoratës në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë dhe përcaktimin e kushteve që duhet të plotësojë studenti për marrjen e diplomës për gradën shkencore "Doktor"
- **Udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 21**, datë 30/07/2009 "Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në programet e studimit të doktoratës në Institucionet publike të Arsimit të Lartë"
- **Udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 39**, datë 08/12/2009 "Disa ndryshime në Udhëzimin Nr. 21, datë 30/07/2009 "Për procedurat e pranimit dhe



## UNIVERSITETI POLITEKNIK, TIRANË FAKULTETI I GJEOLGJISE DHE I MINIERAVE

Adresa: Rruga e Elbasanit, Tiranë - Albania

Tel/Fax: 35542375 246/5

E-mail: [fgjeolmin@yahoo.com](mailto:fgjeolmin@yahoo.com)

<http://www.dibmin-fgjm.org/doktorata/>

të regjistrimit në programet e studimit të doktoratës në Institucionet publike të Arsimit të Lartë”

- **VKM Nr. 103**, datë 17/02/2010 “ Për një shtesë në VKM Nr.864, datë 05/12/2007 “Për hapjen e programeve të studimeve të Doktoratës në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë dhe përcaktimin e kushteve që duhet të plotësojë studenti për marrjen e diplomës për gradën shkencore “Doktor”, të ndryshuar.
- **VKM Nr. 593**, datë 18/08/2011 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.864, datë 5.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për hapjen e programeve të studimeve të Doktoratës në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë dhe përcaktimin e kushteve që duhet të plotësojë studenti për marrjen e diplomës për gradën shkencore “Doktor””, të ndryshuar.
- **Udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 22**, datë 14/09/2012 “Një ndryshim dhe disa shtesa në udhëzimin Nr.21 datë 30.07.2009 “Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në programet e studimit të doktoratës në Institucionet publike të Arsimit të Lartë” i ndryshuar”

### Neni 1 - Objektivat e Programit të Studimeve të Doktoratës

1. Programi i Studimeve të Doktoratës në “**GJEOSHKENCAT, BURIMET NATYRORE DHE MJEDISI**”, është pjesë e programit të studimeve të ciklit të tretë, që ofrohet nga Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës.
2. Ky program ka për qëllim të pajisë studentët me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të kryer kërkim shkencor me nivel të lartë pranë universiteteve, institucioneve publike, dhe institucioneve / organizmave private; duke zhvilluar më tej progresin shkencor dhe projektimin në fushat e Shkencave të Tokës, të Burimeve Natyrore dhe të Mjedisit , si dhe krijimin e një grupi specialistesh me nivel të lartë njohurish, që do të mund t'i paraprijnë kërkimit shkencor duke qenë të aftë të bashkëpunojnë edhe në nivele ndërkombëtare.
3. Këto objektiva realizohen përmes aktiviteteve mësimore dhe kërkimit shkencor me cilësi të lartë.

### Neni 2 - Fushat e Kërkimit Shkencor

1. Programi i studimeve të Doktoratës “Gjeoshkencat, Burimet natyrore dhe Mjedisit” përfshin fushat e kërkimit shkencor në:
  - a. Gjeologji (për kërkim, zbulim, vlerësim të vë të mineraleve të ngurta apo të naftës dhe gazit, për specialitete të veçanta të fushës së Gjeologjisë)
  - b. Gjeoinxhinieri
  - c. Gjeomjedis



**UNIVERSITETI POLITEKNIK, TIRANË**  
**FAKULTETI I GJEOLGJISE DHE I MINIERAVE**

*Adresa: Rruga e Elbasanit, Tiranë - Albania*

*Tel/Fax: 35542375 246/5*

*E-mail: [fgjeolmin@yahoo.com](mailto:fgjeolmin@yahoo.com)*

*<http://www.dibmin-fgjm.org/doktorata/>*

- d. Inxhinierinë e Naftës
- e. Gjeofizikë
- f. Burimet e Energjisë
- g. Gjeologji Inxhinierike
- h. Hidrogeologji
- i. Gjeoinformatikë
- j. Gjeomatikë
- k. Përpunim Mineralesh dhe Mbetjesh

### **Neni 3 - Hapja e konkursit të pranimit**

1. Çdo njoftim për hapjen e konkursit për pranimin në Programin e Studimeve të Doktoratës, shpallet me Urdhër të Rektorit dhe duhet të njoftohet në mediat elektronike/të shtypit të shkruar, në mjediset e Fakultetit si dhe në faqen e internetit.
2. Njoftimi duhet të përfshijë:
  - a. Kurrikulën mësimore të Programit të Studimeve të Doktoratës
  - b. Kohëzgjatjen e Programit të Studimeve ;
  - c. Afatin për paraqitjen e aplikimeve;
  - d. Metodologjinë e përdorur për të kryer përzgjedhjen;
  - e. Kriteret e vlerësimit të kandidatëve;
  - f. Numrin maksimal të kandidateve që do të pranohen;
  - g. Numrin e bursave të ofruara;
  - h. Afatin e dorëzimit të dokumentave për kandidatët fitues me qëllim regjistrimin në Programin e Studimeve të Doktoratës;
  - i. Kriteret për pranimin në vitin pasues pas vitit të parë të studimeve;
  - j. Aktet që mund të sjellin pezullimin dhe/ose revokimin e bursave;
  - k. Tarifat që duhen paguar nga studentët dhe rregullin për specifikimin e rasteve të veçanta ku ndodhin përjashtime nga rregullat e përgjithshme;
  - l. Të drejtat dhe detyrimet e çdo studenti;

### **Neni 4 - Kërkesat për pranimin në Programin e Studimeve të Doktoratës**

1. Aplikimet për Doktoratë pranohen nga kandidatë që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve duke fitur Diplomën "Master i Shkencave" ose një diplomë ekuivalente me të, sipas akteve ligjore në fuqi, në diplomat e fituara në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave dhe degë të tjera që përmbajnë të paktën 60% të programit të

**Cikli i tretë i studimeve: Rregullorja e Programit të Studimeve të Doktoratës " Burimet Natyrore, Gjeoshkencat dhe Mjedisi".**



**UNIVERSITETI POLITEKNIK, TIRANË**  
**FAKULTETI I GJEOLGJISE DHE I MINIERAVE**

*Adresa: Rruga e Elbasanit, Tiranë - Albania*

*Tel/Fax: 35542375 246/5*

*E-mail: [fgjeolmin@yahoo.com](mailto:fgjeolmin@yahoo.com)*

*<http://www.dibmin-fgjm.org/doktorata/>*

diplomave të Fakultetit të Gjeologjisë dhe të Minierave, ose një titull studimi ekuivalent fituar jashtë shtetit dhe të njohur zyrtarisht nga organet kompetente, sipas akteve ligjore në fuqi.

2. Mesatarja e ponderuar e notave në studimet e Bachelor plus Master Shkencor **duhet të jetë më e madhe, ose e barabartë me 8 (tetë), ose 80 % e pikëve totale.**
3. Kandidatët për doktorantë të kenë dhënë provimin e gjuhës angleze (në përputhje me Ligjin e AL , Neni 26, pika 1.3.1 c).
4. Kandidatët mbi moshën 40 vjeç duhet të kenë eksperience si punonjës akademikë ose kërkimorë të pasqyruar në projekte, raporte apo botime shkencore.

**5. Kritere të tjera:**

- a) Rëndësia e subjektit të tezës së doktoratës që propozohet nga kandidati në bashkëpunim me udhëheqësin;
  - b) Pëlqimi i njesisë së kërkimit për pritjen/udhëheqjen e kandidatit (brenda Universitetit Politeknik);
  - c) Gadishmëria e një punonjësi akademik (ose dy) për ta udhëhequr kandidatin;
  - d) Mundësitë financiare për të mbuluar punën kërkimore.
6. Kandidatët aplikojnë për t'u regjistruar në një program studimi doktorate me dosje individuale, e cila duhet të përmbajë dokumentet e mëposhtme:
- a) Kërkesën e kandidatit drejtuar këshillit të profesorëve të Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave që është përgjegjës për organizimin dhe administrimin e doktoratës , ku të saktësohet:
    - emri i programit të ciklit të tretë që dëshiron të ndjekë;
    - emri i diplomës të ciklit të dytë që zotëron, ose diplomë tjetër ekuivalente me të.
    - Fusha specifike në të cilën kërkimorë të realizojë kërkimin shkencor
    - Kandidati duhet të saktësojë se është në dijeni dhe do të përmbushë gjithë kërkesat që rrjedhin nga detyrimet ligjore dhe financiare në fuqi.
  - b) CV personale dhe bibliografi të punimeve shkencore, të cilat duhet të jenë të dokumentuara, nëse kandidati ka të tilla.
  - c) Kopje të noterizuar të diplomës Bachelor dhe Master Shkencor apo të diplomave të tjera studimi, ekuivalente me to, të shoqëruara me kreditet dhe listën e notave apo suplementin e diplomës. Diplomat e huaja duhet të shoqërohen me vërtetimin e njohjes nga MASH-i.
  - d) Kopje të noterizuar të diplomave apo çertifikatave të kualifikimeve të ciklit të tretë apo të një diplome ose çertifikate ekuivalente me to, shoqëruar me listën e notave apo suplementin e diplomës, nëse kandidati disponon një të tillë.



**UNIVERSITETI POLITEKNIK, TIRANË**  
**FAKULTETI I GJEOLGJISE DHE I MINIERAVE**

*Adresa: Rruga e Elbasanit, Tiranë - Albania*

*Tel/Fax: 35542375 246/5*

*E-mail: [fgjeolmin@yahoo.com](mailto:fgjeolmin@yahoo.com)*

*<http://www.dibmin-fgjm.org/doktorata/>*

- e) Vërtetim për vazhdimin e programeve të studimit të specializimit, së bashku me listën e notave të fituara deri në atë moment, nëse kandidati është duke ndjekur një program të tillë.
- f) Vërtetime të tjera të nevojshme për të garantuar kërkesat e pikës 4 më sipër.
- g) Pranimin, me shkrim, të një punonjësi akademik me titull Profesor ose Profesor i Asociuar (ose dy) për ta udhëhequr kandidatin si dhe një përshkrim i përgjithshëm i drejtimit kërkimor që mendohet të ndërmerret;
- h) Fotokopje të noterizuar të kartës së indentitetit/pasaportës.
- i) Dy fotografi.
- j) Dy rekomandime nga persona me titull Akademik, Prof. ose Prof. Asoc .
- k) Një deklaratë që pranon të shlyejë të gjitha detyrimet financiare lidhur me koston e këtyre studimeve, sipas përcaktimeve të bëra nga vetë institucioni.
- l) Dëshmi të gjuhës angleze (në përputhje me Ligjin e AL, Neni 26, pika 1.3.1 c) (fotokopje të noterizuar).
- m) Vërtetim nga qendra e punës, nëse është i punësuar.
- n) Mandat për tarifën e aplikimit për konkurim (tarifa shpallet në lajmërimin për hapjen e konkurimit).

6. Kandidati ka në dispozicion një afat prej dy javësh për dorëzimin e aplikimit nga data e hapjes së konkursit të pranimit në programin e Doktoratës.

### **Neni 5 – Pranimi i kandidatëve në Programin e Studimeve të Doktoratës**

- 1) Pranimet në Programin e studimeve të Doktoratës përcaktohen bazuar në një klasifikim të përgjithshëm sipas meritave, kryer nga Këshilli i Profesorëve, derisa të plotësohet numri i vendeve të publikuara (përcaktuar me VKM).
- 2) Kandidatët e pranuar në Doktoratë bazuar në listën finale do të humbin të drejtën e tyre për t'u regjistruar në Programin e studimeve të Doktoratës nëse nuk paraqesin dokumentat e nevojshme për regjistrim brenda afateve të përcaktuara nga lajmërimi.
- 3) Të gjithë aplikimet për doktoraturë shqyrtohen paraprakisht nga Këshilli i Doktoratës, i cili në bashkëpunim me Këshillin e Profesorëve të njësisë kryesore përgjegjëse për Programin e studimeve të Doktoratës , ngre komisione *ad-hoc*, sipas departamenteve, të përbërë nga anëtarë të brendshëm dhe të jashtëm të personelit akademik të drejtimit të studimit në fjalë, që kanë së paku gradën shkencore "doktor". Kryetari i çdo komisioni është përgjegjësi i departamentit. Në rastet kur përgjegjësi i departamentit



**UNIVERSITETI POLITEKNIK, TIRANË**  
**FAKULTETI I GJEOLGJISE DHE I MINIERAVE**

*Adresa: Rruga e Elbasanit, Tiranë - Albania*

*Tel/Fax: 35542375 246/5*

*E-mail: [fgjeolmin@yahoo.com](mailto:fgjeolmin@yahoo.com)*

*<http://www.dibmin-fgjm.org/doktorata/>*

nuk ka titullin "Profesor" ose "Profesor i Asociuar", Këshilli i Profesorëve cakton një prej antarëve të tij, sipas fushave përkatëse, si Kryetar. Përgjegjësi i departamentit është anëtar i Komisionit *ad-hoc*. Komisioni *ad-hoc*, pas një seleksionimi paraprak të kandidatëve të cilët plotësojnë kriteret e përgjithshme, procedon me renditjen e tyre në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë Rregullore. Në këtë renditje, në përputhje me Udhëzimet e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, prioritet kanë kandidatët që janë personel akademik i punësuar me kohë të plotë në IAL.

Këtë renditje Komisioni *ad-hoc* ia paraqet Dekanit, i cili grumbullon vlerësimet e gjithë komisioneve të ngritur dhe i paraqet në Këshillin e Profesorëve të Fakultetit, jo më vonë se dy javë nga mbyllja e aplikimeve. Lista e kandidatëve fitues e miratuar nga Këshilli i Profesorëve shpallet nga Dekani jo më vonë se tre javë nga mbyllja e aplikimeve.

Nëse aplikimi për doktoraturë nuk pranohet dhe në rast se mbeten vende të lira në Programin e Studimeve të Doktoratës, kandidati ka të drejtë të aplikojë përsëri, por duhet të plotësojë disa dokumente që pasqyrojnë vërejtjet dhe kërkesat specifike të Komisioneve që kanë shqyrtuar dosjen e tij.

- 4) Renditja finale e kandidatëve bëhet publike në mjedise të dukshme në Fakultet dhe në website-in e Programit të Studimeve të Doktoratës .
- 5) Nëse një prej aplikuesve tërhiqet përpara fillimit të Doktoratës, vendi do t'i ofrohet aplikuesit të parë në renditjen e listës.
- 6) Kandidatët fitues paguajnë një tarifë (specifikuar në lajmërimin e hapjes së konkurimit) për regjistrim në programin e studimit të doktoratës ku janë shpallur fitues. Dosja individuale me dokumentet e aplikantëve jofitues u kthehet atyre kundrejt kërkesës në dorë ose me postë.
- 7) Studentët e regjistruar, të cilët kanë përfunduar ose vijojnë programe studimi të ciklit të tretë, nuk janë të detyruar të grumbullojnë 60 kreditet e studimeve të organizuara teorike, pjesë e programit të studimit të doktoraturës, vetëm nëse programi i studimit të cilin ata kanë përfunduar apo vijojnë ka formim teorik të njëjtë ose të afërt me atë të programit të doktoratës.
- 8) Këshilli i profesorëve ngre komisionet e drejtuara nga kordinatori i Programit të studimeve të Doktoratës për njohjen dhe transferimin e krediteve të fituara nga studentët e regjistruar, të cilët kanë përfunduar ose vijojnë një program studimi të ciklit të tretë në varësi të përputhshmërisë së tyre me programin e studimit të doktoratës ku ai është regjistruar. Për çdo student të tillë përcaktohen veprimtaritë formuese, modulet lëndore dhe kreditet përkatëse, të cilat ai është i detyruar t'i fitojë nga plani i studimeve të organizuara të programit të studimit përkatës të doktoratës.

**Cikli i tretë i studimeve: Rregullorja e Programit të Studimeve të Doktoratës " Burimet Natyrore, Gjeoshkencat dhe Mjedisi".**



**UNIVERSITETI POLITEKNIK, TIRANË**  
**FAKULTETI I GJEOLGJISE DHE I MINIERAVE**

*Adresa: Rruga e Elbasanit, Tiranë - Albania*

*Tel/Fax: 35542375 246/5*

*E-mail: [fgjeolmin@yahoo.com](mailto:fgjeolmin@yahoo.com)*

*<http://www.dibmin-fgjm.org/doktorata/>*

- 9) Kandidatët që nuk fitojnë të drejtën për t'u regjistruar në Programin e Studimit të Doktoratës kanë të drejtë të paraqesin ankimmimin e tyre pranë Dekanit të Fakultetit, jo më vonë se 5 ditë pas shpalljes së listës së kandidatëve fitues.
- 10) Dekani i kërkon Këshillit të Profesorëve të shqyrtojë ankesën brenda 7 ditëve. Vendimi i Këshillit të Profesorëve është i formës së prerë.


### **Neni 6 - Aplikime të Pavlefshme**

Kandidati nuk mund të ndjekë njëkohësisht dy programe studimi, e vertetuar me deklaratë personale.

### **Neni 7 - Organizimi i Programit të Studimeve të Doktoratës**

1. Programi i studimit të Doktoratës është përgjegjësi e Këshillit të Profesorëve, Dekanit dhe Këshillit të Fakultetit. Për programin e studimeve të Doktoratës, Këshilli i Profesorëve ngre **Këshillin e Doktoraturës** i cili përbëhet nga Dekani (ose zv/dekani për shkencën), Kordinatori i Doktoratës, 4 profesorë të brendshëm (një përfaqësues nga çdo departament) si dhe një vend lihet për përfaqësuesin e doktorantëve. Përzgjedhja e këtij të fundit bëhet pas regjistrimit të tyre në studimet e doktoraturës.
2. Programi i studimit të Doktoratës drejtohet nga Kordinatori i Doktoratës i cili përzgjidhet nga Këshilli i Profesorëve dhe miratohet nga Dekani. Ai duhet të jetë i aftë të drejtojë atë me korrektësi e kompetencë. Kordinatori i Doktoratës duhet të ketë titullin "Profesor" si dhe të ketë eksperiencë të gjatë në mësimdhënie e kërkim shkencor në mënyrë të veçantë të ketë udhëhequr doktorantë në përgatitjen e disertacionit si dhe të ketë marrë pjesë në komisione të vlerësimit të doktoratave.
3. Në strukturën e punimeve në doktoraturë ka një program mësimor i cili përmban kurse teorike (70% të kohës ose 40-45 kredite) dhe përpunimin e projektit shkencor (15-20 kredite). Plani mësimor paraqitet nga Kordinatori i Doktoratës, diskutohet në Këshillin e Doktoraturës, Këshillin e Profesorëve, në Këshillin e Fakultetit *dhe miratohet nga Rektori*.
4. Realizimi i programit mësimor të ciklit teorik ndiqet dhe kontrollohet nga Kordinatori i Doktoratës në bashkëpunim me Dekanin, Këshillin e Doktoraturës, Këshillin e Profesorëve dhe Përgjegjësit e Departamenteve të përfshirë në Programin e Studimeve të Doktoratës.





**UNIVERSITETI POLITEKNIK, TIRANË**  
**FAKULTETI I GJEOLGJISE DHE I MINIERAVE**

*Adresa: Rruga e Elbasanit, Tiranë - Albania*

*Tel/Fax: 35542375 246/5*

*E-mail: [fgjeolmin@yahoo.com](mailto:fgjeolmin@yahoo.com)*

*<http://www.dibmin-fgjm.org/doktorata/>*

**Neni 8 - Organizimi i Kërkimit në Programin e Studimeve të Doktoratës**

1. Doktoratura është pjesë e sistemit: 3 vjet (formim fillestar universitar) plus 2 vjet Master dhe 3 vjet doktoraturë (gjithesjt: 3 + 2 + 3 = 8 vjet). Programi i studimit të Doktoratës zhvillohet kryesisht me shkëputje nga puna (me kohë të plotë).

Mbrotja e Doktoraturës konsiston në:

- a. Përgatitjen e një disertacioni orgjinal në disipinën e paracaktuar në formën e një teze me karakter personal.
- b. Prezantimin publik të punës duke vënë në evidencë cilësitë e tij, orgjinalitetin e punës kërkimore si dhe kapacitetin e paraqitjes në auditor.

Për të qenë kandidat në një program studimi doktorate nevojiten të paktën 300 kredite të diplomave "Bachelor + Master i Shkencave". Pjesa tjetër prej 60 kreditesh që nevojiten, grumbullohen para mbrojtjes së disertacionit të doktoratës.

2. Programi i Studimeve të Doktoratës vazhdon për 3 vjet me kohë të plotë dhe deri 6 vjet me kohë të pjesëshme. Zgjatja më shumë se 4 vjet (me kohë të plotë ose e ekuivalentuar me kohe të pjesëshme afërsisht 6 vjet) duhet të aprovohet nga Këshilli i Doktoraturës, Këshilli i Profesorëve, Këshilli i Fakultetit.

Gjatë doktoraturës doktoranti duhet të sigurojë nga të gjitha kurset (teorike, stazhe, pjesmarrje në konferenca etj.) të paktën 60 kredite sipas një programi të përgatitur që në fillim dhe të nënshkruar nga Doktoranti, Udhëheqësi dhe Kordinatori i Doktoratës. Kurset teorike zhvillohen mbi bazën e një plani mësimor teorik të përgatitur dhe aprovuar nga: Këshilli i Doktoraturës, Këshilli i Profesorëve, Këshilli i Fakultetit/Senati i Universitetit dhe Dekani/Rektori. Në kurset teorike duhet të zhvillohen së paku katër module teorike të detyrueshme për të gjithë doktorantët e programit të studimeve të doktoratës.

3. Këshilli i Profesorëve përzgjedh udhëheqësit shkencorë, të aftë për të drejtuar punën kërkimore të studentëve, mbështetur në vlerësimin e veprimtarive kërkimore botuese të tyre, brenda e jashtë vendit.

Udhëheqësi shkencor i studentit të doktoratës është përgjegjës për drejtimin, këshillimin, vlerësimin e nevojave të studentit, si dhe për zhvillimin e monitorimin e përparimit të punës kërkimore të studentit. Ai duhet të ketë titullin akademik "Profesor", "Profesor i Asociuar" ose gradën shkencore "Doktor" (PhD), të fituar në universitetet e vendeve të zhvilluara dhe ka veprimtari të pasur kërkimore dhe botuese në fushën përkatëse shkencore. Lista e shteteve, doktorata e të cilëve konsiderohet për këtë qëllim, miratohet me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, me propozim të



**UNIVERSITETI POLITEKNIK, TIRANË**  
**FAKULTETI I GJEOLGJISE DHE I MINIERAVE**

*Adresa: Rruga e Elbasanit, Tiranë - Albania*

*Tel/Fax: 35542375 246/5*

*E-mail: [fgjeolmin@yahoo.com](mailto:fgjeolmin@yahoo.com)*

*<http://www.dibmin-fgjm.org/doktorata/>*

Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës (KALSH), Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akademikë (KVTA) dhe Konferencës së Rektorëve.


Doktorantët udhëhiqen nga personeli akademik i disiplinës respektive të studimit të doktoratës, me titull “Profesor” ose “Profesor i Asociuar”, ose me gradën shkencore “Doktor” (PhD) të fituar në universitete përëndimore. Udhëheqësi shkencor me titullin akademik “Profesor”, i punësuar me kohë të plotë, udhëheq njëkohësisht jo më shumë se pesë doktorantë. Udhëheqësi shkencor me titullin akademik “Profesor i Asociuar” dhe udhëheqësi shkencor me gradën shkencore “Doktor” (PhD) të fituar pranë universiteteve përëndimore, i punësuar me kohët të plotë, udhëheq njëkohësisht, jo më shumë se dy doktorantë. Udhëheqësi me titullin akademik “Profesor”, i punësuar me kohë të pjesshme, udhëheq vetëm një doktorant.

Një punonjës akademik i një universiteti jo publik nuk mund të jetë udhëheqës i doktoraturës veçse si bashkë udhëheqës, ku udhëheqës kryesor është një punonjës akademik i Universitetit Politeknik të Tiranës.

4. Udhëheqës të doktoraturës mund të jenë 2 punonjës akademikë të brendshëm të universiteteve të ndryshme brenda Shqipërisë (nga të cilët njëri nga UPT), kur rëndësia e kërkimit ose rrethanat e studimit e kërkojnë një gjë të tillë. Bashkëudhëheqës i doktoraturës mund të jetë një punonjës akademik i brendshëm i një universiteti jashtë Shqipërisë. Në rastet e bashkëudhëheqjes realizimi i doktoraturës udhëhiqet në kotutelë.
5. Përveç rastit kur kandidatit i është dhënë miratimi nga Këshilli i Doktoraturës, bazuar në rekomandimet e Udhëheqësit përkatës të doktoraturës, për të punuar në një institucion apo qendër kërkimore /laborator kërkimor, etj, nën drejtimin e bashkë udhëheqësit, puna kërkimore duhet të kryhet në Programin e Studimit “Gjeoshkencat, Burimet Natyrore dhe Mjedisi” që ka përgjegjësinë dhe kompetencën shkencore të fushës. Në rast se puna kërkimore nga natyra është multidisiplinare, duhet të ketë një bashkëpunim ndërmjet Programit kryesor të Doktoratës dhe Programeve të tjera që marrin pjesë në proces.

Kandidati duhet të ndjekë punën kërkimore për periudhën e paraqitur më sipër dhe po ashtu të ndjekë një program të tillë studimi në Universitet siç mund të jetë përshkruar nga Këshilli i Doktoraturës në bashkëpunim me udhëheqësin e Doktoraturës.

6. Një shqyrtim formal i avancimit të punës kërkimore të kandidatit kryhet nga Këshilli i Doktoraturës, të paktën një herë në vit. Udhëheqësi duhet të dorëzojë një raport me shkrim sipas një formati të paracaktuar dhe Këshilli i Doktoraturës duhet ta shqyrtojë atë, së bashku me një raport të shkruar nga kandidati (sipas një formati të paracaktuar). Këshilli i Doktoraturës, pas një mbledhjeje, formulon rekomandime për Këshillin e



**UNIVERSITETI POLITEKNIK, TIRANË**  
**FAKULTETI I GJEOLGJISE DHE I MINIERAVE**

*Adresa: Rruga e Elbasanit, Tiranë - Albania*

*Tel/Fax: 35542375 246/5*

*E-mail: [fgjeolmin@yahoo.com](mailto:fgjeolmin@yahoo.com)*

*<http://www.dibmin-fgjm.org/doktorata/>*

Profesorëve mbi avancimin e punës së kandidatit. Pas shqyrtimit të këtyre rekomandimeve, Këshilli i Profesorëve merr një vendim për progresin nga ana e tij në bashkëpunim me udhëheqësin e doktoratës. Kandidati mund të ankimojë një vendim që pengon avancimin e punës së tij kërkimore në Këshillin e Profesorëve. Ankimimi i kandidatit shqyrtohet nga Këshilli i Profesorëve, vendimi i të cilit është përfundimtar.

7. Udhëheqësi i doktoratës duhet të jetë një punonjës akademik apo shkencor, i punësuar me kohë të plotë apo të pjesshme, brenda Universitetit Politeknik. Për punonjësit akademikë që kanë mbushur moshën e pensionit apo kur periudha e përgatitjes së doktoratës del përtej datës së daljes në pension të udhëheqësit atëherë Këshilli i Doktoraturës në bashkëpunim me përgjegjësin e njësisë propozon një punonjës akademik të dytë si bashkë udhëheqës doktrature. Vetëm punonjësit akademikë të cilët janë në marrdhënie pune me universitetin mund të caktohen udhëheqës doktrate.
8. Në rast konflikti midis kandidatit dhe udhëheqësit ose përgjegjësit të njësisë, Dekani cakton një punonjës tjetër akademik të zgjidhë konfliktin duke u propozuar dy palëve një marrëveshje e cila duhet të kihet në konsideratë prej tyre. Në rast se konflikti nuk zgjidhet, vetë Dekani ndërhyr për zgjidhje dhe në rast se edhe kjo nuk funksionon, i kërkohet Këshillit të Profesorëve të shprehet nëse kandidati mund të vazhdojë kërkimin në këtë njësi/Institucion nën drejtimin e një udhëheqësi tjetër.
9. Kandidatët në programin e studimeve të doktoratës mund të jenë shtetas shqiptarë, qytetarë me dy shtetësi (ku ajo shqiptare është një prej tyre) dhe të huaj me njohuri të mjaftueshme të gjuhës shqipe.

### **Neni 9- Të drejtat dhe detyrimet e studentit të Doktoratës**

1. Studentët e regjistruar në Programin e Studimeve të Doktoratës duhet të ndjekin leksionet, seminarët dhe të gjitha aktivitetet mësimore, të kryejnë aktivitetet e kërkimit shkencor në strukturat e përcaktuara për këtë qëllim dhe të dorëzojnë në fund të vitit një raport mbi punën e kryer pranë Këshillit të Doktoraturës.
2. Gjatë periudhës së kërkimeve doktoranti merr pjesë aktive në seminare, konferenca dhe në mësimdhënie nën mbikqyrjen e udhëheqësit të doktoratës. Po ashtu, ai duhet të referojë në grupin kërkimor që mbulon tematikën e temës të paktën një herë në vit.



**UNIVERSITETI POLITEKNIK, TIRANË**  
**FAKULTETI I GJEOLGJISE DHE I MINIERAVE**

*Adresa: Rruga e Elbasanit, Tiranë - Albania*

*Tel/Fax: 35542375 246/5*

*E-mail: [fgjeolmin@yahoo.com](mailto:fgjeolmin@yahoo.com)*

*<http://www.dibmin-fgjm.org/doktorata/>*

3. Përgatitja e doktoratës duhet të shoqërohet me një mobilitet të paktën tremujor të studentit të doktoratës në universitete apo institute kërkimore të huaja, me burime financiare individuale ose me projekte kombëtare apo ndërkombëtare.
4. Gjatë periudhës së studimeve të doktoratës, përpara paraqitjes në mbrojtjen e doktoratës, studentit duhet të ketë plotësuar kushtet e mëposhtme:
  - a) të ketë realizuar, si autor i parë, së paku, tri referime ose paraqitje (poster) shkencore, nga të cilat dy referime ose paraqitje duhet të jetë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare në një vend të zhvilluar (simpozium, konferencë, kongres), të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "Proceedings, të indeksuara me kod ISBN-je. Lista e shteteve, në të cilat veprimtaritë shkencore ndërkombëtare dhe referimet e mbajtura ose paraqitjet (poster) shkencore do të njihen, miratohet me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, me propozim të Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës, Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akademikë dhe Konferencës së Rektorëve;
  - b) të ketë botuar, si autor i parë, së paku tre artikuj shkencorë në revista shkencore. Së paku, dy prej artikujve duhet të jenë botuar ose pranuar për botim në revista shkencore të njohura të vendeve të zhvilluara sipas listës së miratuar me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, me propozim të Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës, Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akademikë dhe Konferencës së Rektorëve;
  - c) të ketë përgatitur dhe paraqitur në Këshillin e Profesorëve të Fakultetit disertacionin, së bashku me një përmbledhje, të miratuara nga udhëheqësi shkencor;
  - d) të ketë dhënë provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.
5. Këshilli i Profesorëve mund të vendosë të përjashtojë një student nga Programi i Studimeve të Doktoratës nëse verifikohet një nga rastet e mëposhtme:
  - a. Mosshlyerja e detyrimeve të ciklit teorik brenda një afati maksimal prej 2 vjetësh nga data e regjistrimit në Programin e Studimeve të Doktoratës.
  - b. Shprehja e një vlerësimi negativ nga ana e udhëheqësit të Doktoratës lidhur me pranimin në vitin tjetër të studimeve; në këtë rast Këshilli i Profesorëve verifikon realizimin e rezultateve të kërkuara si dhe shkallën e angazhimit e kandidatit në punën kërkimore të kryer;
  - c. mungesa të gjata (mbi 30% e kohës së planifikuar për kërkim në programin vjetor).



**UNIVERSITETI POLITEKNIK, TIRANË**  
**FAKULTETI I GJEOLGJISE DHE I MINIERAVE**

*Adresa: Rruga e Elbasanit, Tiranë - Albania*

*Tel/Fax: 35542375 246/5*

*E-mail: [fgjeolmin@yahoo.com](mailto:fgjeolmin@yahoo.com)*

*<http://www.dibmin-fgjm.org/doktorata/>*

6. Studenti i Doktoratës ka të drejtë të marrë leje-lindje ose për sëmundje serioze.
7. Mungesa për arsye të tjera të pa listuara më sipër duhet të autorizohet nga Këshilli i Profesorëve.
8. Kur një student nuk arrin të shlyej detyrimet e programit të studimit në afatin e parashikuar, atëhere ai e shlyen atë/ato detyrim/e në sezonet e provimeve të vitit pasardhës.

### **Neni 10 - Disertacioni i Doktoratës**

1. Titulli "Doktor" fitohet kur studentin kalon me sukses mbrojtjen e disertacionit të Doktoratës, mbrojtje e cila mund të përsëritet vetëm një herë.
2. Në fund të studimeve të Programit të Studimeve të Doktoratës, studentin i regjistruar në vitin e fundit dorëzon kërkesën për t'u pranuar në mbrojtjen e disertacionit të doktoratës pranë Këshillit të Profesorëve. Kërkesa shoqërohet dhe me dosjen e plotë të tij ku përfshihet disertacioni i përgatitur, një përmbledhje e miratuar nga udhëheqësi shkencor, mendimi i udhëheqësit shkencor si dhe mendimi i Departamentit përkatës.
3. Këshilli i Profesorëve vendos nëse kandidati do të pranohet në mbrojtjen e disertacionit, duke hartuar një raport të detajuar lidhur me punën e kandidatit gjatë Doktoratës.
4. Në rastin e mos miratimit të kërkesës, kandidati i jepet përgjigje me shkrim, me firmën e Drejtuesit të Këshillit të Profesorëve. Kandidati ka të drejtë të riparqesë kërkesën për të filluar procedurën e mbrojtjes jo më parë se gjashtë muaj, pas refuzimit të kërkesës së parë.
5. Për arsye të justifikuara që paraprijnë dorëzimin e disertacionit në afatin e caktuar, Dekani, me propozim të Këshillit të Profesorëve, mund të akordojë një shtyrje të afatit për dorëzimin e disertacionit në vitin akademik pasues. Një shtyrje e tillë mund të akordohet deri në dy herë.
6. Për të përfutur një shtyrje të afatit një kandidat duhet të dorëzojë një kërkesë dhe opinionin pozitiv të Këshillit të Profesorëve.
7. Në rast se doktoranti nuk arrin të përfundojë ose ndërpret përgatitjen e disertacionit në afatin e caktuar, ai mund të pajset me një vërtetim për rezultatet e arritura.



**UNIVERSITETI POLITEKNIK, TIRANË**  
**FAKULTETI I GJEOLGJISE DHE I MINIERAVE**

*Adresa: Rruga e Elbasanit, Tiranë - Albania*

*Tel/Fax: 35542375 246/5*

*E-mail: [fgjeolmin@yahoo.com](mailto:fgjeolmin@yahoo.com)*

*<http://www.dibmin-fgjm.org/doktorata/>*

**Neni 11 - Komisioni i vlerësimit për lëshimin e titullit “Doktor”**

1. Vendimi i Këshillit të Profesorëve për pranimin e kandidatit në mbrojtjen e disertacionit duhet të merret jo më vonë se dy muaj nga dita e regjistrimit pranë Sekretarisë së Dekanit të dosjes së plotë të doktorantit dhe duhet të shoqërohet me propozimin e anëtarëve të komisionit vlerësues (jurisë) për mbrojtjen publike të disertacionit të doktoratës. Vendimi i Këshillit të Profesorëve si dhe propozimi për përbërjen e jurisë së mbrojtjes, i përcillen Dekanit të fakultetit, i cili kontrollon zbatimin e procedurës dhe ja përcjell për miratim përfundimtar Rektorit të Universitetit. Juria e mbrojtjes përbëhet prej 5 vetësh, 1 kryetar dhe 4 anëtarë, ku të paktën tre prej të cilëve duhet të kenë titullin “Profesor”. Në rastet kur nuk mund të gjenden dy anëtarët e tjerë me këtë titull, pranohen anëtarë me titullin “Profesor i asociuar” dhe kanë përvojë të mjaftueshme akademike e shkencore brenda dhe jashtë vendit. Tre prej anëtarëve të Jurisë duhet të jenë të jashtëm për UPT-në.

Përbërja e jurisë i propozohet Këshillit të Profesorëve nga koordinatori i programit të doktoratës/përgjegjësi i departamentit. KP-ja shqyrton dhe miraton jurinë për zhvillimin e provimit të doktoratës. KP-ja përcakton dy ose tre oponentë, një prej të cilëve duhet të jetë nga jashtë institucionit. Oponentët janë edhe anëtarë të jurisë për vlerësimin e disertacionit. Ata duhet të kenë titujt akademikë të kërkuar dhe veprimtari kërkimore e botuese të pasur, brenda e jashtë vendit, në fushën përkatëse të studimeve, në të cilën ofrohet edhe programi i studimeve të doktoratës.

Një anëtar i jurisë së provimit të doktoratës mund të jetë nga universitete të njohura në botë, për cilësi dhe veprimtari të pasur kërkimore dhe botuese në fushën përkatëse, i cili ka, së paku, gradën shkencore “doktor”, të fituar në fushën shkencore në të cilën vazhdon studimet doktoranti, dhe mbi 5 (pesë) vjet përvojë akademike e kërkimore.

Këshilli i Profesorëve, propozimin e vet për përbërjen e jurisë ia komunikon paraprakisht doktorantit, i cili ka të drejtë të bëjë vërejtje për ndryshimin e saj dhe, në rast mungese mirëkuptimi, mund t’i drejtohet Rektorit të Universitetit, që jep vendimin përfundimtar.

2. Komisioni i vlerësimit (juria) miratohet nga Rektori bazuar në propozimin e Këshillit të Profesorëve, jo më vonë se nëntëdhjetë ditë pas përfundimit të Programit të Studimeve të Doktoratës.

**Neni 12 - Mbrojtja e disertacionit të Doktoratës dhe fitimi i titullit “Doktor”**



**UNIVERSITETI POLITEKNIK, TIRANË**  
**FAKULTETI I GJEOLGJISE DHE I MINIERAVE**

*Adresa: Rruga e Elbasanit, Tiranë - Albania*

*Tel/Fax: 35542375 246/5*

*E-mail: [fgjeolmin@yahoo.com](mailto:fgjeolmin@yahoo.com)*

*<http://www.dibmin-fgjm.org/doktorata/>*

1. Disertacioni i doktoratës paraqitet përpara Komisionit të Vlerësimit dhe konsiston në mbrojtjen publike të tij. **Grada** "Doktor" fitohet vetëm pas kalimit me sukses të mbrojtjes së disertacionit të doktoratës.
2. Kandidati dhe anëtarët e Komisionit të Vlerësimit duhet të njoftohen të paktën shtatë ditë përpara ditës së mbrojtjes lidhur me vendin dhe orarin e mbrojtjes me anë të një njoftimi zyrtar.
3. Kandidati duhet të pajisë çdo anëtar të Komisionit të Vlerësimit me një kopje të disertacionit; kjo e fundit shoqërohet nga raporti i përpiluar nga Këshilli i Profesorëve dhe mendimi i përgatitur nga udhëheqësi. Të paktën tri ditë para mbrojtjes të gjithë anëtarët e jurisë duhet të kenë në dispozicion oponentat e përgatitura.
4. Mbrojtja e disertacionit bëhet me pjesëmarrjen e plotë të jurisë. Kur mungon ndonjë pjesëtar i jurisë, mbrojtja shtyhet për një datë tjetër.

Procedura e mbrojtjes së doktoratës përfshin:

- Leximin nga kryetari i jurisë të lejes së mbrojtjes dhe të përbërjes së jurisë, të miratuar nga Rektori i Universitetit.
  - Paraqitje e përmbledhjes së disertacionit nga kandidati për një kohë prej 30-35 minuta.
  - Paraqitje e oponentave.
  - Pyetje drejtuar kandidatit nga juria (dhe eventualisht të pranishmit) rreth disertacionit dhe vërejtjeve të oponentave dhe përgjigjet për to në trajtën e një debati direkt.
  - Diskutime
  - Sqarime e replika eventuale nga disertanti dhe udhëheqësi shkencor.
5. Vlerësimi i doktorantit në provimin e mbrojtjes së disertacionit bëhet i hapur. Rezultati i vlerësimit bëhet publik dhe pasqyrohet në proces verbalin përkatës.
  6. Disertacioni i rrëzuar mund të ripunohet dhe të paraqitet për mbrojtje për herë të dytë, pas një periudhe prej 1 deri 2 vjetësh, pas së cilës humbet e drejta për rimbrotjen e tij.
  7. Kur Komisioni i Vlerësimit ka rekomanduar që dhënia e gradës "Doktor" të jetë e kushtëzuar me korrigjimet që duhet ti bëhen disertacionit, udhëheqësi kryesor është përgjegjës për monitorimin e zbatimit të këtyre korrigjimeve, dhe oponenti i brendshëm (në konsultim edhe me oponentin e jashtëm nëse paraqitet e nevojshme) është përgjegjës për të siguruar që ndryshimet e bëra përmbushin kërkesat e shprehura nga Komisioni i Vlerësimit (juria).



**UNIVERSITETI POLITEKNIK, TIRANË**  
**FAKULTETI I GJEOLGJISE DHE I MINIERAVE**

*Adresa: Rruga e Elbasanit, Tiranë - Albania*

*Tel/Fax: 35542375 246/5*

*E-mail: [fgjeolmin@yahoo.com](mailto:fgjeolmin@yahoo.com)*


*<http://www.dibmin-fgjm.org/doktorata/>*

8. Kandidati nuk mund të fitojë gradën deri sa disertacioni i rishikuar, duke përfshirë ndryshimet e nevojshme ashtu siç është konfirmuar nga oponenti i brendshëm, të mbërrijë në Sekretarinë e Dekanit të Fakultetit.
9. Kandidati duhet të dorëzojë tre kopje të disertacionit final pranë Sekretarisë së Dekanit të Fakultetit, e cila është përgjegjëse për depozitimin e tyre pranë Bibliotekës së Universitetit.
10. Diploma "Doktor", pasi nënshkruhet nga Dekani dhe Rektori, regjistrohet në regjistrin e gradave të Universitetit Politeknik dhe në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.
11. Marrëveshjet e partneritetit ndërkombëtar mund të sjellin përfshirjen e rregullave ekstra për lëshimin e titullit "Doktor".
12. Grada shkencore "Doktor" është e revokueshme në çdo kohë dhe për çdo rast, që konstatohet plagjiaturë ose manipulim të dhënash në punimet e kandidatit. Në këtë rast, Dekani i kërkon Këshillit të Profesorëve të mblidhet menjëherë dhe ta shqyrtojë rastin e konstatuar. Vendimi i Këshillit të Profesorëve shqyrtohet nga Këshilli i Etikës së UPT-së, i cili i propozon Rektorit revokimin e gradës shkencore "Doktor", të fituar nga kandidati. Rektori, pasi e shqyrton, merr vendim, të cilin ia dërgon kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akademikë për të bërë çregjistrimin nga regjistri përkatës i këtij Komisioni. Të drejtën e revokimit të gradës shkencore "Doktor" e ka edhe Rektori i UPT-së si dhe Komisioni i Vlerësimit të Titujve Akademikë, kur ka informacione të besueshme në lidhje me këtë çështje. UPT-ja ka të drejtën e revokimit të gradës shkencore "Doktor" për diplomat e lëshuara për marrjen e kësaj grade, edhe në rastet kur konstatohet plagjiaturë apo manipulim të dhënash në studime/punime kërkimore të kryera pas promovimit për marrjen e saj.

### **Neni 13 -Doktoratat e përbashkëta**

1. Universitetet mund të organizojnë programe të përbashkëta të studimit të doktoratës me një a më shumë universitete të tjera, në bazë marrëveshjesh midis tyre, duke pasur parasysh si më poshtë:
  - Programi i studimit të doktoratës dhe përgatitja e disertacionit të saj kryhen me periudha të alternuara në secilin prej universiteteve pjesëmarrëse.
  - Caktimin e dy udhëheqësve, një për secilin universitet, për studentët që zhvillojnë programe të tilla. Vlerësimi pozitiv i të dy udhëheqësve është kusht për të kaluar në mbrojtjen e disertacionit të doktoratës.
  - Caktimin e gjuhës në të cilën do të hartohet dhe paraqitet disertacioni i doktoratës apo pjesë të tij, përcaktuar në marrëveshjen midis universiteteve.





**UNIVERSITETI POLITEKNIK, TIRANË**  
**FAKULTETI I GJEOLGJISE DHE I MINIERAVE**

*Adresa: Rruga e Elbasanit, Tiranë - Albania*

*Tel/Fax: 35542375 246/5*

*E-mail: [fgjeolmin@yahoo.com](mailto:fgjeolmin@yahoo.com)*

*<http://www.dibmin-fgjm.org/doktorata/>*

- Anëtarët e jurisë për mbrojtjen e disertacionit caktohen me vendim të autoriteteve drejtuese të secilit universitet.
- 2. Diploma "Doktor" lëshohet nga të dy Universitetet dhe nënshkruhet nga secili universitet (me të dy stemat e Universiteteve).

Miraturar nga Këshilli i Profesorëve të Fakultetit të Gjeologjisë dhe të Minierave të Universitetit Politeknik të Tiranës në mbledhjen e datës 11.03.2013 dhe nga Këshilli i Fakultetit të Gjeologjisë dhe të Minierave të Universitetit Politeknik të Tiranës në mbledhjen e datës ....3.2013

### **Neni 14 –Dispozita kalimtare**

Kjo Rregullore zbatohet për të gjithë studentët që kanë filluar studimet e doktoratës në vitin akademik 2011-2012 e në vijim, ndërsa studentët, që i kanë filluar studimet para daljes së **VKM Nr. 593**, datë 18/08/2011 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.864, datë 5.12.2007 të Këshillit të Ministrave "Për hapjen e programeve të studimeve të Doktoratës në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë dhe përcaktimin e kushteve që duhet të plotësojë studenti për marrjen e diplomës për gradën shkencore "Doktor"", të ndryshuar, i përfundojnë ato sipas Rregullores së mëparëshme.

Kryetari i Këshillit të Profesorëve

Kryetari i Këshillit të Fakultetit

Prof.Dr. Ilir Alliu

Prof.Dr. Përparim Hoxha